



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:217441
Datë: 19.03.2025
Numri i dokumentit: 07011953

AA.nr.450/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Hajriz Hoti kryetar, Ramiz Kuqi dhe Arsim Hamzaj anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, F.K nga Prishtina, të cilin me autorizim e përfaqëson, Jeton Osmani, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, me seli në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2455/2022, të datës 06.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 07.03.2025, merr këtë,

A K T V E N D I M

Miratohet si e bazuar ankesa e të paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve-Departamenti i Pensioneve me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2455/2022, i datës 06.02.2024, prishet dhe lënda i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, nën shenjë A.nr.2455/2022, i datës 06.02.2024, është vendosur, “*Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit F.K nga Prishtina. ANULOHET vendimi i Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve me numër të dosjes 377304 i datës 12.09.2022, dhe paditësit i njihet e drejta në Pensionin Kontributpagues të Moshës në kategorinë e tretë me shkollim të lartë në shumë prej 214 euro për muaj. OBLIGOHET e paditura, Ministria e Financave Punës dhe Transfereve Departamenti i Administratës Pensionale, që paditësit në mënyrë retroaktive t’ia kompensoj pagesat (diferencën) në mes shumes së pensionit bazë dhe atë kontributiv dhe atë nga dt.03.05.2022 deri me dt.26.12.2023 në shumë të përgjithshme prej 2,280.00 euro (Dy mijë e dyqind e tetëdhjetë euro) dhe interesin në shumën prej 231.04 euro (Dyqind e tridhjetë e një euro e katër centë) në shumë të përgjithshme prej 2,511.04 (Dymijë e pesëqinda e njëmbëdhjetë euro e katër cent) të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga marrja e këtij Aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.*”

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë e paditura, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë ta aprovoj ankesën si të bazuar, të prishë aktgjykimin e kontestuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i të paditurës i datës 12.09.2022.

Paditësi ka ushtruar përgjigje në ankesë për mes të autorizuarit të tij, me të cilën e ka kundërshtuar ankesën e të paditurës, dhe i ka propozuar gjykatës që ta refuzoi në tërësi ankesën e të paditurës si të pa bazuar.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, përgjigjes në ankesë dhe pas vlerësimit të tyre duke u bazuar në nenin 49 paragrafi 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 194 dhe 195.1 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka gjetur se ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datë;21.10.2022, kundër vendimit të të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, të dt.12.09.2022, sepse konsideron se vendimi i kundërshtuar me padi është i pa bazuar dhe jo të ligjshëm, për arsye se nuk është vlerësuar drejtë gjendja faktike nga ana e organeve administrative, si dhe është zbatuar gabimisht edhe ligji material, me propozim që i njëjti të anulohet si i kundërligjshëm, dhe ti njihet e drejta në pension kontribut pagues të moshës.

Gjykata e shkallës së parë pasi ka vlerësuar vendimin e kundërshtuar dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të seancës së shqyrtimit kryesor, bie aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e aprovon kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, me arsyetim se *“Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 44 par.1 të LKA-së, pasi vlerësoi ligjshmërinë e Vendimit kontestues, vlerësimit të thënieve në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë çështje administrative, dhe thënieve në seancën e shqyrtimit kryesor vërtetoi se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar. Paditësi ka parashtruar kërkesë nr. të dosjes 377304, për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues të moshës në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve - Departamenti i Pensioneve në Prishtinë dhe se e paditura, në bazë të provave të lëndës e ka njoftuar paditësin me vendimin e datës 12.09.2022, mbi refuzimin e ankesës si të pabazuar, për ti njohur të drejtën në Pension Kontributpagues të Moshës, duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 8 të Ligjit Nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, se nuk janë bashkangjitur dëshmi të mjaftueshme të stazh kontribut pagues për 15 vite stazh, në bazë të dokumentacionit dhe dëshmitë e marrëdhënies së punës për të lartcekurin, pasi që janë prezantuar 9 vite e 2 muaj. Gjykata nga arsyetimi i vendimit të kundërshtuar konstaton se organi i paditur gjatë zhvillimit të procedurës administrative të ankesave, nuk ka dhënë sqarime të duhura lidhur me dëshmitë e prezantuara nga paditësi, të cilat i ka shqyrtuar gjatë shqyrtimit të ankesës së paditësit në procedimin administrativ. Në asnjë rast e paditura nuk përmend në arsyetim të vendimit kontestues se cilat dëshmi i ka paraqit paditësi dhe të njëjtat i ka konsideruar të pamjaftueshme në kuptim të Ligjit në fuqi. Gjykata e konsideron të papranueshëm dhe arbitrar një arsyetim të tillë të vendimit kontestues, ku e paditura nuk sqaron pretendimet ankimore të paditësit gjatë procedurës ankimore. Mos arsyetimi i provave të paraqitura nga paditësi është në kundërshtim me dispozitat e nenit 48 paragrafi 1 pika 1.5 të Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, që parasheh: Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve. Gjithashtu e paditura me rastin e vendosjes në procedurën ankimore, nuk ka respektuar dispozitat e nenit 134 të të njëjtit Ligj, që parasheh: Krahas kërkesave të nenit 48 të këtij Ligji, arsyetimi i aktit administrativ që zgjidh ankesën, do të përmbajë gjithashtu vlerësimet e të gjitha pretendimeve të parashtruara nga pala në ankesë. Nga arsyetimi i vendimit kontestues gjykata nuk ka mund të kuptoj se cilat prova materiale janë konsideruar nga e paditura si të pranueshme dhe që dëshmojnë se paditësi ka vetëm 9 vite 2 muaj stazh pune, dhe nuk është e qartë se e paditura gjatë shqyrtimit të ankesës ka pasur në disponim të gjitha provat materiale që janë vendimtare me rastin e vlerësimit të stazhit pensional kontributpagues të paditësit. Me aktvendimin A.nr. 2455/22 të datës 19.12.2023, është caktuar*

ekspertja financiare për Hartimin e ekspertizës financiare me qëllim të llogaritjes së diferencës të pensionit bazë dhe atij kontributiv sipas shkollimit. Ekspertja pas shqyrtimit të shkresave të lëndës përllëgarit dhe përcakton muajit e papaguar nga data 03.05.2022 deri në përpilimin ekspertizës, kur paditësit i është refuzuar kërkesa për këtë pension deri me datën e nxjerrjes së ekspertizës. Sipas kësaj ekspertize për periudhën kohore nga data 03.05.2022 deri me datën e ekspertizës 26.12.2023 shumën në mes pensionit të moshës dhe atij kontributiv me Shkollë të Lartë shuma për tërë periudhën nga data 03.05.2022 deri me datën 26.12.2023 paditësi kishte me realizuar pension kontributiv kategori III ku diferenca në mes pensionit të moshës dhe kontributiv është në shumën prej 2,280.00 euro (Dymijë e dyqindën e tetëdhjetë euro) kurse interesi është shumen 231.04 euro (Dyqind e tridhjetë e një euro e katër centë). Organi i paditur nuk ka arsyetuar fare se përse nuk i është dhënë njohje juridike provave si në vijim: Vërtetim i lëshuar nga Komuna e Malishevës ku përcaktohet se paditësi ka përvojë punë 6 vite nga viti 1990 deri 1996 dhe vërtetimi i DKA së Komuna e Malishevës dt. 12.04.2022 ku vërtetohet se paditësi ka qenë i angazhuar në sistem arsimor nga 01.09.1981 deri 31.08.1996 pra 15 vite.”

Kolegji i Gjykatës të Apelit, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes dhe pas ekzaminimit të aktgjykimit të ankimuar dhe shkresave të lëndës, e duke i pasur parasysh edhe pretendimet ankimore, vëren se aktgjykimi i kontestuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) dhe neni 183 të LPK-së, se është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij për çka në mënyrë të bazuar theksohet në ankesë. Prandaj pikëpamjet juridike të Gjykatës së shkallës së parë nuk mund ti përkrahë si të rregullta dhe të ligjshme për arsye se, arsyet në të cilat bazohen faktet vendimtare lidhur me mënyrën e vendosjes, janë jo të qëndrueshme dhe në kundërshtim me faktet të cilat e paditura i thekson në ankesë, e rrjedhimisht nga kjo edhe e drejta materiale nuk është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Me provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor nga gjykata e shkallës së parë, kolegji apelit verën se paditësi nuk ka dëshmi të vlefshme për pagesën e kontributeve pensionale sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës;01.01.1999, dhe Ligjit NR.08/L-248 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit NR.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuar nga Shteti, e jo siç ka nxjerrë përfundim Gjykata e shkallës së parë, kur ka konstatuar se “*Me aktvendimin A.nr. 2455/22 të datës 19.12.2023, është caktuar ekspertja financiare për Hartimin e ekspertizës financiare me qëllim të llogaritjes së diferencës të pensionit bazë dhe atij kontributiv sipas shkollimit. Ekspertja pas shqyrtimit të shkresave të lëndës përllëgarit dhe përcakton muajit e papaguar nga data 03.05.2022 deri në përpilimin ekspertizës, kur paditësit i është refuzuar kërkesa për këtë pension deri me datën e nxjerrjes së ekspertizës. Sipas kësaj ekspertize per periudhën kohore nga data 03.05.2022 deri me datën e ekspertizës 26.12.2023 shumën në mes pensionit të moshës dhe atij kontributiv me Shkollë të Lartë shuma për tërë periudhën nga data 03.05.2022 deri me datën 26.12.2023 paditësi kishte me realizuar pension kontributiv kategori III ku diferenca në mes pensionit të moshës dhe kontributiv është në shumën prej 2,280.00 euro (Dymijë e dyqindën e tetëdhjetë euro) kurse interesi është shumen 231.04 euro (Dyqind e tridhjetë e një euro e katër centë). Organi i paditur nuk ka arsyetuar fare se përse nuk i është dhënë njohje juridike provave si në vijim: Vërtetim i lëshuar nga Komuna e Malishevës ku përcaktohet se paditësi ka përvojë punë 6 vite nga viti 1990 deri 1996 dhe vërtetimi i DKA së Komuna e Malishevës dt. 12.04.2022 ku vërtetohet se paditësi ka qenë i angazhuar në sistem arsimor nga 01.09.1981 deri 31.08.1996 pra 15 vite.”*

Prandaj, kolegji i apelit nuk mund të pranojë si të drejtë një qëndrim të tillë të paraqitur në aktgjykimin e ankimuar, sepse ka të meta të tilla për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, dhe se i njëjti është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten edhe arsyetimin e tij, dhe provat e mangëta dhe të pa administruara, nga Gjykata e shkallës së parë në drejtim të

kontributeve të paguara pensionale nga paditësi, edhe pse i njëjti ka përvojë të mjaftueshme të punës, por nuk ka dëshmi që e vërtetojnë faktin se i njëjti i ka paguar kontributet pensionale për periudhën sa është kërkuar me ligj.

Për arsyet e dhëna më lart, aktgjykimi i kundërshtuar është dashur të priset dhe çështja t'i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rigjykim, për t'i mënjanuar shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) dhe neni 183 të LPK-së, që janë të tilla që pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktgjykimit të kontestuar nga e paditura.

Mbi këto arsye, detyrohet gjykata e shkallës së parë që në ri procedurë të mënjanoj mangësitë e paraqitura më lartë, përkatësisht të kërkoj sipas detyrës zyrtare nga organi i paditur, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve-Departamenti i Pensioneve, që gjykatës së shkallës së parë t'ia dërgojë të gjitha shkresat e lëndës për të vërtetuar se a janë plotësuar kriteret për njohjen e të drejtës në pension kontribut pagues, pasi që e paditura ka dëshmi të mjaftueshme për të gjithë punonjësit e Kosovës në arkivat e saj. Ngase, roli aktiv i organit të paditur shihet nga detyrimi që së bashku me përgjigje në padi, gjykatës është i detyruar t'ia dërgojë komplet shkresat e lëndës lidhur me rastin që zhvillohet konflikti administrativ. Prandaj, në afatin e caktuar pala e paditur ka për detyrë t'ia dërgojë gjykatës së shkallës së parë të gjitha shkresat që kanë të bëjnë me lëndën. Nëse pala e paditur edhe pas kërkesës së dytë nuk ia dërgon shkresat e lëndës, apo nëse deklaron se nuk mund t'ia dërgojë, gjykata e shkallës së parë do të vendosë për çështjen edhe pa shkresat e lëndës. Po ashtu, të kërkohet edhe nga organi i punësimit të paditësit dhe paditësi që të provohet para gjykatës së shkallës së parë se paditësi ka paguar kontributet pensionale, përkatësisht, ka stazh kontribut pagues deri më datë 01.01.1999, ashtu siç është përcaktuar me Ligjin Nr.08/L-248 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, dhe pastaj varësisht nga gjendja e vërtetuar faktike pas marrjes së kësaj prove, dhe përmes zbatimit të drejtë të së drejtës materiale, përkatësisht Ligjit Nr.08/L-248 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, të vendos sipas padisë së paditësit. Po ashtu nëse nuk mund të provohet se paditësi ka paguar kontribute pensionale siç është kërkuar me ligj, atëherë duhet ti njihet e drejta në pension parcial kontribut pagues, nëse paditësi provon para gjykatës se hynë në kategorinë e personave që është larguar nga puna si rezultat i masave të dhunshme, sipas Ligjit Nr.08/L-248 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit NR.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, përkatësisht, dispozitës ligjore të nenit 8/A, që i referohet, pensionit parcial kontributpagues i moshës. Gjithashtu gjykata të kërkoj nga e paditura zyrtarisht dëshmi për lartësinë e shumës së pensionit parcial që i njihet kësaj kategorie, dhe varësisht nga gjendja e vërtetuar faktike, përmes zbatimit të drejtë të së drejtës materiale, përkatësisht Ligjin Nr.08/L-248 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit NR.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, të vendos sipas padisë së paditësit, dhe më pas të nxjerr aktgjykim të drejtë dhe të ligjshëm.

Mbi këto arsye Gjykata ka mundësi të bie aktgjykim të drejtë dhe të ligjshëm në kuptim të dispozitave të nenit 8A të Ligjit Nr.08/L-248 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti.

Mbi këtë bazë, e në mbështetje të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, si dhe neni 195 paragrafi 1 pika c), të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.450/2024, datë 07.03.2025

Kryetari i kolegjit
Hajriz Hoti